

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Fejzullah Rexhepi kryetar, Ramë Hyseni dhe Qerim Ademaj anëtarë, në çështjen juridike të paditëses R.M. nga fshati ... Komuna Skenderaj, të cilin e përfaqëson B.L., avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Komuna Skenderaj - Drejtoria Komunale e Arsimit Skenderaj, të cilin e përfaqëson me autorizim avokati Publik Komunal F.S., në çështjen për kompensimin e pagave jubilarë dhe për përcjellje në pension, vlera 1322.16€, duke vendosur lidhur me ankesën e të autorizuarit të paditëses, e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë, Dega në Skenderaj, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.184/13, të datës 06.06.2014, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën **29.12.2016**, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pa themeltë ankesa e të autorizuarit të paditëses R.M. nga fshati ... Komuna Skenderaj, ndërsa aktgjykimi Gjykatës Themelore në Mitrovicë, Dega në Skenderaj, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.184/13, të datës 06.06.2014, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar, C.nr.184/13, të datës 06.06.2014, ka refuzuar në tërësi si të pa bazuar padinë e paditëses R.M. nga fshati ... Komuna Skenderaj, me të cilën ka kërkuar që të: detyrohet e paditura Komuna Skenderaj - Drejtoria Komunale e Arsimit Skenderaj që paditëses t'ia paguaj, borxhin në shumën prej 1322.16€, me kamatë prej 8% nga data e paraqitjes së padisë deri në pagesën definitive dhe të ja kompensoi shpenzimet procedurale në shumë 20 euro, të gjitha në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Kundër aktgjykimit C.nr.184/13, të datës 06.06.2014, brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë i autorizuari i paditëses, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkallës së dytë ta aprovoj ankesën e të autorizuarit të paditësit dhe aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë C.nr.184/13, të datës 06.06.2014, të ndryshoj dhe të aprovoj kërkesëpadinë si të bazuar ose aktgjykimin e atakuar ta prishi dhe lëndën t'ia kthej gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

Gjykata e Apelit e Kosovës, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin dhe aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim me dispozitave të nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

-Ankesa është e pa themelta

Nga shkresat e lëndës rrjedhë se paditësi ka ushtruar padi ndaj të paditurës me kërkesë për kompensimin e pagave jubilarë dhe për përcjellje në pension. Gjykata e shkallës së parë pas mbajtjes së seancës kryesore ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit duke u bazuar në faktin se në bazë të ligjit të punës nuk është përcaktuar si obligim i punëdhënësve për kompensimin e pagave jubilarë dhe për përcjellje në pension, ndërsa kontrata kolektive në të cilën e bazon kërkesën pala paditëse nuk ka qenë në fuqi. Po ashtu gjykata e shkallës së parë e ka arsyetur vendosjen si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, me faktin se kërkesat nga kërkesëpapia nuk janë paraparë as me ligjin e punës (nr.03/L-149). Sa i përket shpenzimeve të procedurës ka vendosur konform nenit 450 të LPK-së.

Gjykata e Apelit e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm sa i përket vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit C.nr.184/13, të datës 06.06.2014, për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe nuk ka shkelje nga neni 182 par.2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së dhe nuk ka aplikim të gabuar të drejtës materiale për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Sipas nenit 43 dh3 44 kontratës së përgjithshme kolektive është përcaktuar se punëtori varësisht nga përvoja e punës ka të drejtë në kompensimin e pagave jubilarë, si dhe të drejtën në pagën përcjellëse me rastin e pensionimit në lartësi të dy pagave minimale mujore të punëtorit në Kosovë, ndërsa me nenin 64, po të kësaj kontrate është paraparë se kjo kontratë zbatohet nga 1 Janari 2005. Po ashtu në bazë të nenit 90 paragrafi 4 të Ligjit të punës (Ligji nr. 03/L-212), është përcaktuar se: “marrëveshja kolektive nuk mund të lidhet në kohë më të gjatë se 3 vjet”, në rastin konkret paditësi ka arritur moshën e pensionimit me datën 31.07.2011, për shkak të cilit edhe i përfundon marrëdhënia e punës dhe se kontrata kolektive nuk ka qenë në fuqi në kohën e pensionimit të paditësit. Andaj duke u bazuar në këto dispozita gjykata e shkallës së parë drejt ka vendosur kur e ka refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 195.1 pika d), lidhur me nenin 200, të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.3660/2014 me datë 29.12.2016

Kryetari i kolegjit-Gjyqtari
Fejzullah Rexhepi